



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:247352

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05845023

Ac.nr.10053/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi - Saraçi, në çështjen kontestimore të paditëses B..., kundër të paditurve A. B, K. B dhe M. B, të gjithë nga Prishtina, për borxh, duke vendosur sipas ankesës së paditëses dhe ankesës së të paditurve, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3377/17 të datës 21.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHEN si të pa bazuara, ankesa e paditëses B... dhe ankesa e të paditurve A. B, K. B dhe M. B, të gjithë nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3377/17 i datës 21.07.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses B... dhe detyrohen të paditurit A. B, K. B dhe M. B, të gjithë nga Prishtina, që paditëses në mënyrë solidare t'ia paguajnë shumën prej 13,675.55 €, në emër të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 100 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar paditësja, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditëses si e bazuar, të prishet dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë parashtruar edhe të paditurit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovet ankesa e të paditurve si e bazuar, të priset dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja B..., ka parashtruar padi ndaj të paditurve A. B, K. B dhe M. B, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit A. B, K. B dhe M. B, të gjithë nga Prishtina, që paditëses në mënyrë solidare t'ia paguajnë shumën prej 13,675.55 €, në emër të borxhit.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë administrimin e provave dhe atë: Kontrata për Kredinë Bankare, me numër 77193633, e datës 31.08.2016, Aneksi i planit të pagesave, Parashtresa e pasqyrës së borxhit dhe Njoftimi i datës 02.11.2017.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se: paditësja me të paditurit me datë 31.08.2016, kanë lidhur Kontratë Kredie Bankare me numër 771903633, me të cilën kontratë vërtetohet se ndërmjet palëve ka ekzistuar një marrëdhënie e kontraktuar, me të cilën palët ishin dakorduar se paditësja të jap kredi shumën prej 15,000 €, tani të paditurit të parë si kredimarrës dhe të paditurve të dytë dhe tretë si bashkë-kredimarrës, me afat të kthimit prej 60 muajve, e të cilin detyrim të paditurit nuk e kanë përmbushur.

### **Baza ligjore:**

Neni 194 i LPK-së: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: .....d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur".

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

Gjykata e Apelit vlerëson se, përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, lidhur me çështjen juridike të paditëses, është i drejtë dhe ligjor, ndërsa aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me kurrfarë shkeljesh të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as me të tjerat nga neni 182 i LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, bazuar në dispozitën e nenit 194 të LPK-së. Në kontekst me dispozitat ligjore në fjalë, gjykata e shkallës së dytë e ka shqyrtuar dhe vlerësuar ankesën e paditëses dhe ankesën e të paditurit dhe ka gjetur se të njëjtat janë të pa bazuara, ndërsa gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale.

Kolegji gjen se, në shkresat e lëndës përkatësisht nga kontrata mbi kredinë me numër C771903633 e datës 31.08.2016 është vërtetuar se ndërmjet palëve ka ekzistuar një marrëdhënie e kontraktuar, me të cilën palët ishin dakorduar se paditësja të jap kredi shumë prej 15,000 €, tani të paditurit të parë si kredi marrës dhe të paditurve të dytë dhe tretë si bashkë-kredi marrës, me afat të kthimit prej 60 muajve. Kolegji ka gjetur se qëndron fakti se të paditurit nuk i janë përmbajtur marrëveshjes së lartcekur, andaj bazuar në nenin 262 të LMD-së të paditurit detyrohen që të përmbushin obligimin e tyre ndaj paditëses, si në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar. Neni 262 i LMD-së përcakton se: *“kreditorit ne raportin e obliguar është i autorizuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë që ta përmbushë më ndërgjegje krejtësisht sikur është përmbajtja e tij”*. Në rastin konkret kolegji gjithashtu gjen se, në shkresat e lëndës nuk gjenden prova se është bërë pagesa e kredisë në shumë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Për këto arsye kolegji i ka refuzuar pretendimet e palës së paditur dhe ka vlerësuar se, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar dhe se një vendim i tillë i gjykatës gjen mbështetje në nenin 17.1 të LMD-së, në të cilin është përcaktuar se: *“Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*.

Pretendimet e palës paditëse lidhur me lartësinë e borxhit, kolegji i ka refuzuar si të pa bazuara për faktin se, kolegji ka gjetur se pjesa e kërkuar mbi shumë e gjykuar përbën dënim kontraktues dhe në bazë të dispozitës së nenit 270.3 të LMD-së, *dënimi kontraktues nuk mund të kontraktohet për detyrimet në të holla*. Për arsyet e theksuara si më lartë, kolegji pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse i ka refuzuar si të pa bazuara dhe ka bërë vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Numri i lëndës: 2019:247352  
Datë: 21.06.2024  
Numri i dokumentit: 05845023

Nga arsyet e sipër cekura Gjykata e Apelit duke u bazuar në nenin 195 par.1 pika d) e lidhur me nenin 209 par.1 pika b) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10053/2021 me datë 18.06.2024

Kryetari i kolegjit- gjykatësi,  
Dr.sc. Rafet Haxhaj